



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e datës 28.12.2016 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË FERMERËVE PËR NDARJE TË SERRAVE DHE MAKINAVE MJELËSE

Neni 1

Formimi i Komisionit dhe përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të fermerëve për ndarje të serrave dhe makinave mjelëse të cilat kanë aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim 12-320-25196 e datës 18.05.2017 si dhe Ri-shpalljes 12-320-38359 të datës 20.07.2017 të datës 20.07.2017, në këtë përbërje:

1. Lumnije Ejupi, Shefe e Sektorit për çështje pronëso- juridike Kryesuese
2. Azem Arifi, Zyrtar në Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar
3. Behar Aliu, Zyrtar Ligjor, Sektori për punë të Kuvendit dhe të Komiteteve, anëtar

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati Komisionit

- Bën shqyrtimin e ankesave të fermerëve për ndarje të subvencioneve përkatësisht serrave dhe makinave mjelëse të cilat kanë aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim 12-320-25196 e datës 18.05.2017 si dhe Ri-shpalljes 12-320-38359 të datës 20.07.2017, brenda afatit prej 15 ditë pune pas përfundimit të afatit kohor për paraqitjen e ankesave në pajtim me dispozitat e Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e datës 28.12.2016 dhe legjislacionin në fuqi.
- Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit
- Vendimet e Komisionit merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.
- Mandati i komisionit është tre vjeçar.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit si Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari .

1Nr. 320 - 62393

Lipjan, më 20.11.2017

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

